

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-35/13

**Prishtinë,
17 korrik 2013**

Në çështjen juridike të:

N.N.

Kosove

Përfaqësuar nga avokati

Xh. M.

Kosove

Paraqitësi i kërkesës/Pala ankuese

Kundër

M. L.

Prishtinë

Pala përgjegjëse në kërkesë/ Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, Esmë Erterzi dhe Sylejman Nuredini, anëtarë, në lidhje me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/149/2012 (lënda e regjistruara në AKP me numër KPA00078), e datës 19 prill 2012, pas shqyrtimit të mbajtur më 17 korrik 2013, mori këtë:

AKTGJYKIM

- 1- Refuzohet si e pabazuar ankesa e N. N. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/149/2012, i datës 19 prill 2012 sa i përket kërkesës së regjistruar në AKP më Nr. KPA00078.
- 2- Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/149/2012, i datës 19 prill 2012 sa i përket kërkesës së regjistruar në AKP me Nr. KPA00078.
- 3- Obligohet pala ankuese që t'i paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej € 60 (gjashtëdhjetë euro) brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

Më 22 nëntor 2006, N. N. ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) ku ka kërkuar kthimin në posedimin. Ngastra e kërkuar është n. 1287, që gjendet në komunën e Glllogocit në Komoran, zona kadastrale Komoran, me sipërfaqe prej 3 ha, 12ar dhe 8 m². Kërkesa ishte regjistruar në AKM me nr. KPA00078.

Paraqitësi i kërkesës ka paraqitur kopjen e padisë P. 697/61 të parashtruar në Gjykatën Komunale në Prishtinë, me datë 31 gusht 1961, ku babai i tij ka kërkuar posedimin dhe të drejtat pronësore ndaj pronës së kërkuar, si dhe vendimin 03/8967, i datës 6 korrik 1964 i Sekretariatit Krahinor për Financa, Krahina Autonome e Kosovës dhe Metohisë, që dëshmojnë se nuk ka dokument valid që do ta paraqiste atë si pronar të pronës. Në vazhdim, janë bërë supozime se të gjitha pyjet janë pronë shoqërore, përveç nëse pronësia është provuar më dokumente në shkrim.

Më 06 mars 2007, në një deklaratë të paraqitur në Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, N.N.thotë se në vitin 1928, toka e tij në vendin e quajtur Ostrog, arë dhe kullosë, është marr nga Kooperativa Bujqësore "DRENICA BOAL – Agroprodukt" në Glllogoc.

Në deklaratën e datës 31 maj 2011, N. N. ka thënë se ngastra nr. 1287 është shfrytëzuar nga ai për 52 vite.

Më 19 prill 2011, Sekretariati Ekskluziv i AKP-së, ka gjetur sipas detyrës zyrtare, fletën poseduese nr.190 me ngastrën nr. 1287, ku prona e kërkuar evidentohet si pronë shoqërore.

KKPK-ja përmes vendimit të saj KPCC/D/C/149/2012, të datës 19 prill 2012 e ka hedhur poshtë kërkesën pasi që humbja e posedimit të ngastrës nuk ishte e ndërlidhur me konfliktin e armatosur në Kosovë në vitet 1998/1999.

Vendimi i KKPK-së i është dorëzuar paraqitësit të kërkesës me 13 dhjetor 2012.

Më 11 janar 2013, paraqitësi i kërkesës (këtej e tutje si: pala ankuese) përmes Sekretarisë Ekzekutive të AKP-së ka paraqitur ankesë në Gjykatës Supreme të Kosovës, lidhur me lëndën nr. KPA00078, ku ka përmendur vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimin e gabueshëm të së drejtës materiale.

Ankesa i është dorëzuar palës përgjegjëse në kërkesë (këtej e tutje si: pala përgjegjëse në ankesë) me 14 mars 2013. Pala përgjegjëse në ankesë ka paraqitur përgjigje më 18 prill 2013, ku thotë se kërkesa e paraqitësit të kërkesës/palës ankuese është hedhur poshtë me të drejtë të plotë nga KKPK-ja.

Arsyetim ligjor

Ankesa është paraqitur brenda afatit prej 30 ditësh siç parashihet me ligj (neni 12.1 i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079). Ajo është e pabazuar.

Gjykata Supreme gjeti se nuk kishte vërtetim të gabuar të fakteve dhe as zbatim të gabueshëm të së drejtës procedurale ose materiale. KKPK-ja ka vlerësuar saktë se kërkesa nuk është brenda fushëveprimit të saj.

Sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka ta drejtë nga Komisioni në urdhër për kthim në posedim të pronës nëse paraqitësi i kërkesës dëshmon të drejtën pronësore, ose të drejtën e shfrytëzimit të pronës private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale dhe se ai ose ajo tani nuk është në gjendje t'i ushtrojnë ato të drejta pronësore për shkak të rrethanave që lidhen drejtpërdrejtë apo që rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershor 1999.

Siç duket ka pasur konteste rreth pronës në mes të palës ankuese dhe palës përgjegjëse në ankesë që nga vitet 1960-ta. Duke filluar me padinë P. 697/61 në Gjykatën Komunale në Prishtinë, më datë 31 gusht 1961, ku babai i tij ka kërkuar posedimin dhe të drejtat pronësore ndaj pronës së kërkuar, si dhe vendimin 03/8967, i datës 6 korrik 1964 i Sekretariati Krahinor për Financa në Krahinën Autonome e Kosovës dhe Metohisë, dëshmohet se nuk ka dokument valid që do ta paraqiste atë si pronar të pronës. Në një deklaratë të datës 06 mars 2007 të dhenë në Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, pala ankuese thotë se në vitin 1928, toka e tij në vendin e quajtur Ostrog, arë dhe kullosë, është marrë nga Kooperativa Bujqësore “DRENICA BOAL – Agroprodukt” në Glllogovc

Çështja kontestuese në lidhje me pronën në fjalë dhe humbja e pronës nuk është e lidhur me konfliktin e armatosur 1998/1999. Pala ankuese përmend humbjen e një certificate mbi patundshmërinë nr.7030140351287 gjatë konfliktit. Mund të ketë ndodhur që pala ankuese ta ketë humbur këtë certifikatë për shkak të konfliktit, por pala ankuese e pranon në ankesën e tij se kontesti ekziston qysh nga vitet 1960-ta, të paraqitura në gjykata kompetente dhe se pengimet në posedim lidhur me ngastrën e kërkuar dhe deklaratat e bashkëngjitura në ankesë tregojnë se kontesti për këtë pronës ekziston qysh në vitet 1920-ta. Në deklarata po ashtu thuhet se familja e palës ankuese po e shfrytëzon pronën e kërkuar edhe në ditët e sotme.

Prandaj gjykata gjen se lënda nuk është në juridiksion të saj, sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079. Sipas kësaj dispozite Gjykata Supreme ka juridiksion në rast se nuk mund të ushtrohen të drejtat pronësore sipas rrethanave që lidhen drejtpërdrejtë apo që rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë ndërmjet 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999. Në këtë lëndë, lënda e kësaj kërkesë është qartë e ndërlidhur me konflikte të mëhershme në mes të palës ankuese dhe palës përgjegjëse në ankesë, që kanë ekzistuar para konfliktit të armatosur dhe nuk janë të ndërlidhura me konfliktin 1998/1999.

Bazuar në shqyrtimet e sipërtheksuara dhe në pajtim me Nenin 13.3 (c) të Rregullorës UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, ankesa duhet të refuzohet dhe të konfirmohet vendimi i KKPK-ës për sa i përket pronës kontestuese.

Shpenzimet e procedurës:

Në përputhje me Shtojcën III, nenit 8.4 të Urdhëresës Administrative (UA) 2007/5 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, palët lirohen nga shpenzimet e procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit. Megjithatë, një përjashtim i tillë nuk është i paraparë për procedurat para Kolegjit të Apelit. Si pasojë, regjimi normal i pagesës së taksave gjyqësore të paraparë më Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK-së, 3 tetor 1987) dhe me UA Nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi unifikimin e taksave gjyqësore janë të vlefshme për procedurat para Kolegjit të Apelit.

Kështu që, taksat e mëposhtme të gjykatës zbatohen për procedurat aktuale të apelit:

- Taksa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (neni 10.11 i UA 2008/2): 30 €
- Taksa gjyqësore për nxjerrjen e aktgjykimit, (10.21, 10.15 dhe 10.1 të UA 2008/20) përderisa vlera e kërkesës për të cilën ka vendosur gjykata mund të vlerësohet si e arsyeshme, të jetë më e lartë se 15000 € (50+0.5% të 15000, por jo më shumë se 30 €).

Këto taksa gjyqësore duhet të merren përsipër nga pala ankuese e cila humb rastin. Sipas nenit 45 të Ligjit mbi Taksat Gjyqësore, afati për pagesën e saj është 15 ditë. Neni 47 paragrafi 3 parasheh që në rast se pala nuk paguan taksën brenda afatit, pala do të duhet të paguaj një gjobë prej 50% të shumës së taksës. Nëse pala nuk e paguan taksën në afatin e dhënë, atëherë bëhet ekzekutimi i detyrueshëm i pagesës.

Këshillë ligjore

Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet me mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Esma Erterzi, Gjyqtare e EULEX-it

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Urs Nufer, Referent i EULEX-it